

240



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË POGRADEC

KËRKESË

PËR VENDOSJEN E MASËS SË SIGURIMIT PASUROR  
TË SEKUESTROS PREVENTIVE MBI LLOGARITË BANKARE

- Drejtuar :** Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec
- Kërkues :** Prokuroria e pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, përfaqësuar nga prokurore D [REDACTED] E [REDACTED]
- Objekti :** Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive të llogarive bankare
- Baza Ligjore :** Neni 274 i Kodit të Procedurës Penale

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka regjistruar procedimi penal nr.443, viti 2017, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga aktet e këtij procedimi rezulton se me shkresen Nr.5811 Prot. Datë 11 Tetor 2017, të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, protokolluar pranë nesh me Nr.5053 Prot. Datë 11 Tetor 2017, është bërë referimi në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, i veprës penale të “Pastrimit të produkteve te veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal, në ngarkim të shtetasve R [REDACTED] Sh [REDACTED], B [REDACTED] Sh [REDACTED], K [REDACTED] Sh [REDACTED] dhe E [REDACTED] Sh [REDACTED]. Bashkëlidhur informacionit referues, janë dhe dy urdhera të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave të datës 10 Tetor 2017, “Për bllokimin e

*përkohshem të transaksioneve*” në bankat e Nivelit të Dytë, Tirana Bank dhe Societe Generale Albania.


Në përmbajtjen e informacionit referues, rezulton se shtetasi R [REDACTED] Sh [REDACTED] ka gjetur vdekjen si pasojës e vrasjes me arme zjarri në Athinë të Greqise ne daten 08.10.2017.

Po kështu nga informacioni referues, rezulton se ky shtetas ka qenë i dyshuar si i përfshirë në veprimtarine e trafikimit dhe shitjes së lendeve narkotike ne shtetin grek, si dhe rezulton që në vitet 2009-2017 në dy bankat në fjalë ka veprime bankare, si depozita, tërheqie, derdhje dhe shkembim valutor në shumat që variojnë nga 38.000 (tridhjetë e tetë mijë) Euro në 30.000.000 (tridhjetë milion) lekë te kryera nga te afermit e shtetasit R [REDACTED] Sh [REDACTED] (shtetasit B [REDACTED] Sh [REDACTED], K [REDACTED] Sh [REDACTED], K [REDACTED] Sh [REDACTED] dhe E [REDACTED] Sh [REDACTED]).

Sipas të dhënave të para, rezulton se në llogarinë bankare të shtetasit K [REDACTED] Sh [REDACTED], janë kryer që nga viti 2011 dhe deri ne mars viti 2016 transaksione bankare ( derdhje, terheqje dhe konvertim valute) ne shuma qe variojne nga 38000 euro deri ne 30.000.000 leke. Po keshtu shtetasit B [REDACTED] Sh [REDACTED] rezulton te kete qarkulluar ne Banken Tirana dhe Societe Generale Albania shuma monetare qe variojne nga 13.000 euro deri ne 10.000.000 leke. Shtetasja E [REDACTED] Sh [REDACTED] rezulton te kete investuar ne Raiffeisen Bank me date 15.08.2012 shumen 67500 euro dhe ne daten 27.09.2012 eshte debituar kjo llogari ne shumen 67578 euro.

Bazuar nga sa më sipër si dhe në tërësinë e veprimeve hetimore të deritanishëm vlerësojmë se është e nevojshme vendosja e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi llogaritë bankare pranë Bankës “Societe Generale Albania” dhe “Tirana Bank” ne emër të shtetasve K [REDACTED] Sh [REDACTED], B [REDACTED] Sh [REDACTED] dhe K [REDACTED] Sh [REDACTED]. Vendosja e kësaj mase është e nevojshme pasi lënia e lirë e transaksioneve mbi këto llogari bankare krijon mundësinë e tjetërsimit, ndryshimit dhe fshehjes së këtyre llogarive bankare dhe të shumave të parave në to si dhe krijon mundësinë e kryerjes së zgjatjes dhe rëndimit të pasojave të veprës penale.

**Për këto arsye dhe në bazë të neneve 274 e vijues të K.Pr.Penale,**



**KËRKOJMË:**

1. Vendosijen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi llogaritë bankare si me poshte:
  - a. Llogaria nr. [REDACTED] pranë bankës “Societe Generale Albania” në emër të shtetasit K [REDACTED] Sh [REDACTED]
  - b. Llogaria nr. [REDACTED] pranë bankës “Societe Generale Albania” në emër të shtetasit B [REDACTED] Sh [REDACTED]
  - c. Llogaria nr. [REDACTED] pranë bankës “Banka Tirana” në emër të shtetasit K [REDACTED] Sh [REDACTED]
2. Një kopje e vendimit të gjykatës t’i vihet në dispozicion subjektit që administron objektet e sekuestrimit.

**PROKURORE**  
 D [REDACTED] B [REDACTED]



Kërkesës i bashkangjitet tërësia e akteve procedurale të fashikullit nr.443, viti 2017.